



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 320**  
**Lënda: Bazat e Kirurgjisë**

PROGRAMI I LËNDËS									
Bazat e Kirurgjisë									
Titullari i lëndës:		Yllka Bilushi Prof. D; Phd në Shëndet Publik _____							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	8 ECTS	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	0	0	60	1	106	94	200
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti III, Semestri I							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"							
Kodi i lëndës		INF 320							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		<a href="mailto:yllka.bilushi@univlora.edu.al">yllka.bilushi@univlora.edu.al</a>							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lende studiohet organizmi i punës në kirurgjinë ambulatore dhe spitalore, parimet kryesore të asepsisë dhe antisepsisë, praktikat e përpunimit të plageve, mjetet dhe instrumentet kirurgjikale, grupet e gjakut, Sëmundjet e ndryshme kirurgjikale - që janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e infermierëve të ardhshëm me profesionalitet dhe edukatë mjekësore për të trajtuar pacientë me probleme kirurgjikale.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Njohja me organizimin e punës në kirurgji dhe masat mbrojtëse në të.</li><li>▪ Studimi i metodave specifike dhe jo specifike për diagnozën e pacientëve kirurgjikal.</li><li>▪ Njohje me patologjitë më të shpeshta kirurgjikale dhe rolin e infermierit në diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre patologjive.</li></ul>
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të njohin bazat e punës në kirurgjinë ambulatore dhe spitalore.</li><li>☞ Të njohin dhe të jenë të aftë të praktikojnë metodat e asepsisë dhe antisepsisë</li><li>☞ Të vlerësojnë patologjitë urgjente kirurgjikale dhe ndihmën e parë në to.</li><li>☞ Të njohin patologjitë më të shpeshta kirurgjikale në praktikë.</li></ul>

**KONCEPTET THEMELORE**

1. Organizimi i punës në kirurgji dhe masat mbrojtëse në të.
2. Metodat e diagnostikimit në kirurgji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

3. Patologjitë kirurgjikale më të shpeshta dhe vlerësimi i urgjencave kirurgjikale.
4. Menaxhimi i pacientëve me sëmundje kirurgjikale dhe ushqyerja e tyre.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> – Objekti dhe historiku i kirurgjisë. Lidhja e saj me shkencat e tjera. Asepsia dhe antisepsia. Antisepsia moderne. Aseptika. Profilaksia e infeksionit kontagioz. <i>Metodat e asepsisë dhe antisepsisë ofrojnë një eliminim dhe parandalim të hyrjes së mikrobeve në organizëm. Njohja me infeksionet kirurgjikale lokale dhe ato të gjeneralizuara.</i>	<i>fq 1-5</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 2 – 3</b> –Inflamacioni, format, dekursi. Celuliti, forunkuli, karbunkuli, flegmona, sepsisi kirurgjikal. <i>Njohja me infeksionet kirurgjikale lokale dhe ato të gjeneralizuara..</i>	<i>fq 6 - 11</i>	Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.	<i>fq 33-37</i>	<i>Praktikë 4orë</i>
II.	<b>Tema 4</b> - Dezifektimi dhe sterilizimi i ambientit. Infeksionet hospitalore dhe rrezikshmëria e personelit punonjës, profilaksia e punës në kirurgji. <i>Njohja me metodat kryesore strilizuese dhe dezinfektuese që përdorim në spital dhe diferenca midis tyre.</i>	<i>fq 12-16</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 5 - 6</b> - Pavioni i kirurgjisë, organizimi i punës në spital, detyrat e personelit të kirurgjisë. Kirurgjia ambulatorie, organizimi i punës në të, detyrat e personelit ambulator. <i>Objektivat e ambulatorit dhe menaxhimi i pacientëve në këtë pjesë të kujdesit shëndetësor.</i>	<i>fq 13-22</i>	Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
III.	<b>Tema 7 – 8 – 9</b> - Instrumentet dhe mjetet diagnostikuese në sëmundjet kirurgjikale. Fibrogastroskopia, kolonoskopia, echografia, rëntgenografia, skaneri. <i>Njohja me këto metoda diagnostikuese ka një rol të vecantë në sëmundjet kirurgjikale dhe kërkon bashkëpunim të mirë të mjekut, infermierit dhe pacientit.</i>	<i>fq 23-32</i>	Leksion 3 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
IV.	<b>Tema 10</b> - Operacioni kirurgjikal. Instrumentet që përdoren në operacion. Përgatitja e pacientit për intervent kirurgjikal, fusha operatore. <i>Njohja me ekipin kirurgjikal dhe rolin që ka secili pjesëtar i ekipit në realizimin e operacionit kirurgjikal. Larja e duarve, pozicionimi i pacientit dhe fusha operatore.</i>	<i>fq 33-40</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 11 – 12</b> - Periudha postoperatore, rëndësia dhe kujdesi për të. Terapia Konservative, antibiotiko-terapia dhe medikamentet e tjera. <i>Roli i infermierit në përkujdesjen postoperatore dhe njohja e mirë e komplikacioneve të mundhme të periudhës postoperatore. Fq 40-42.</i>	<i>fq 40-42</i>	Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
V.	<p><b>Tema 13 - 14</b> - Lëngjet dhe elektrolitet. Ushqyerja e të sëmurit kirurgjikal. Gjakut dhe grupet e tij, principet e përdorimit dhe rregullat e dhënies së tij, komplikacionet gjatë dhënies së tij. Zëvendësuesit e tij. <i>Crregullimi i ekuilibrit acido-bazik si një dukuri e periudhës postoperative dhe roli i infermierit në menaxhimin e pacientit. Si përcaktohen grupet e gjakut para momentit të transfuzioneve të nevojshme para ose gjatë operacionit..</i></p> <p><b>Tema 15</b> - Hemorragjia, llojet, mënyrat e ndalimit të tyre, komplikacionet, shkaqet, mjekimi i tyre. <i>Shkaqet e hemorragjisë dhe klasifikimi i hemorragjisë sipas kohës, shkakut dhe pamjes klinike. Si menaxhohet hemorragjia pavarësisht llojit të saj.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><i>Fq 43 - 52</i></p> <p><i>fq 54-61</i></p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
VI.	<p><b>Tema 16 - 17</b> - Llojet e shokut, diagnostikimi dhe trajtimi i tij. Vdekja klinike, ndihma e parë që i jepet pacientit gjatë saj. <i>Shoku si një gjendje klinike që manifestohet me crregullime të rënda në organizem dhe kërkon ndërhyrje të shpejtë për të shpëtuar jetën e pacientit. Klasifikimi i shokut.</i></p> <p><b>Tema 18</b> - Traumat, kuadri klinik dhe llojet e plagëve. Infeksioni i plagëve. <i>Kuadri klinik i plagëve, klasifikimi i tyre. Faktorët që rrisin riskun për infeksionin e plagës dhe simptomat e plagës së infektuar.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><i>fq 62-71</i></p> <p><i>fq 72-74</i></p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
VII.	<p><b>Tema 19</b> - Rrigjenerimi dhe mbyllja e plagës. Parimet e mjekimit të plagëve, rivendosja e tërësisë së indeve. <i>Tri fazat klasike të rigjenerimit të plagës dhe rigjenerimi primar dhe ai sekondar.</i></p> <p><b>Tema 20 – 21</b> - Frakturat dhe luksacioni, embolia dhjamore. <i>Klasifikimi i shumëllojshëm i frakturave bazuar në disa faktorë si: koha e shfaqjes, dëmtimi ose jo i lëkurës, lokalizimi, në varësi të veprimit të agjentit traumatik etj.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><i>fq 75-81</i></p> <p><i>fq 82-92</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 2 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
VIII.	<p><b>Tema 22 – 23</b> - Panriciumi, mastitis, osteomieliti, gangrena, tetanozi. Infeksionet e enëve të gjakut, angitet, flebitet, tromboflebitet. <i>Shenjat klinike të këtyre patologjive, mënyra e trajtimit të tyre.</i></p> <p><b>Tema 24</b> - Djegia dhe ngrirja, dëmtimi i organizmit nga temperaturat. <i>Klasifikimi i djegieve dhe ndihma mjekësore në një rast të djegies. Ngrirja dhe simptomat që shfaqen gjatë saj.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.</p>	<p><i>fq 93-104</i></p> <p><i>fq 105-109</i></p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 4 orë</i></p>
IX.	<p><b>Tema 25</b> - Komplikacionet e djegieve. <i>C'është plastika dhe përdorimi i saj, disa metoda të përdorimit. Plastika është një specialitet kirurgjikal e cila përfshin rivendosjen, rindërtimin dhe alternimin e trupit njerëzor.</i></p> <p><b>Tema 26 – 27</b> - Sëmundjet e ezofagut. <i>Patologjitë kryesore që prekin ezofagun, ezofagiti e deri te kanceri i ezofagut, simptomat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi..</i></p>	<p><i>fq 110-111</i></p> <p><i>fq 111 - 124</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 2 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
X.	<b>Tema 28 - 29</b> – Sëmundjet e stomakut. <i>Patologjitë kryesore të stomakut, simptomat klinike që manifestojnë dhe diagnostikimi e trajtimi i tyre.</i> <b>Tema 30</b> – Patologjitë e zorrëve. <i>Ileusi dhe klasifikimi i tij, etiologjia, simptomat klinike të ileusit, diagnoza infermierore dhe trajtimi.</i>	<i>fq 125-133</i>  <i>fq 134-139</i>	Leksion 2 orë  Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XI.	<b>Tema 31</b> - Sëmundjet e apendiksit, ndërhyrja kirurgjikale. <i>Shkaqet e apendicitit akut, simptomat klinike dhe trajtimi kirurgjikal.</i> <b>Tema 32 - 33</b> - Sëmundjet kirurgjikale te rektumit dhe kolonit. <i>Morbus Crohn, simptomat klinike të saj, diagnoza dhe trajtimi. Hemorroidet, klasifikimi i tyre, faktorët e riskut dhe trajtimi.</i>	<i>fq 151-157</i>  <i>fq 158-172</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XII.	<b>Tema 34</b> - Sëmundjet e rrugëve biliare, kolecistës dhe heparit. <i>Njohja me disa sëmundje të heparit që nga hepatitet, cirroza hepatike e deri te hemokromatoza.</i> <b>Tema 35 – 36</b> – Sëmundjet kirurgjikale të shpretkës dhe pankreasit. <i>Klasifikimi i pankreatiteve, simptomat klinike, si diferencohet pankreatiti akut nga ai kronik. Mënyrat diagnostikuese dhe trajtuese të pankreatiteve duke u bazuar te shkaktari.</i>	<i>fq 173-186</i>  <i>fq 187- 227</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XIII.	<b>Tema 37</b> - Herniet e vecanta sipas lokalizimit. Herniet post-operatore. <i>Koncepti i hernies, sipmtomat klinike sipas llojit dhe lokalizimit dhe metodat diagnostikuese e trajtuese të sëmundjes herniare.</i> <b>Tema 38 – 39</b> - Traumata e abdomenit. <i>Shkaktarët e traumave abdominale. Si manifestohen klinikisht dhe si menaxhohet pacienti në këto raste që shpesh përbëjnë urgjenca kirurgjikale.</i> <i>Fq 238-247</i>	<i>fq 228-237</i>  <i>fq 238-2247</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XIV.	<b>Tema 40</b> - Traumata torakale. <i>Shkaktarët e traumave torakale. Si manifestohen klinikisht dhe si menaxhohet pacienti në këto raste që shpesh përbëjnë urgjenca kirurgjikale.</i> <b>Tema 41 - 42</b> - Traumata e kokës. Rehabilitimi në traumata e kokës. <i>Etiologjia e traumave të kokës, roli i rëndësishëm i infermierit në menaxhimin e këtyre pacientëve.</i>	<i>fq 248-251</i>  <i>fq 252-260</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Kirurgjisë.		<i>Praktikë 4 orë</i>
XV.	<b>Tema 43</b> – Patologjite kirurgjikale të arterieve dhe venave. Arterioskleroza. Aneurizma arteriale. <i>Njohja e tablosë klinike të sëmundjeve të arterieve dhe venave, metodat e diagnostikimit, strategjitë e reja të trajtimit dhe monitorimi i pacientëve me vaskulite .</i> <b>Tema 44 – 45</b> - Arteriopatitë kronike okluzive. Okluzioni akut arterial.	<i>fq 260-267</i>  <i>fq 268-291</i>	Leksion 1 orë  Leksion 2 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Patologjitë kryesore okluzive me shkaqe të ndryshme si inflamatore apo autoimune.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin Kirurgjisë.</p>		<i>Praktikë 4 orë</i>

### FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

<b>FREKUENTIMI:</b>	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>						
<b>KONTROLLI I VAZHUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>	
	Provimi i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Provimi final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	60 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Realizim teknikash infermiore	Demonstrim procedure në përkujdesjen infermiore	
	<p>*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të praktikës për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstronë në mënyrë periodike teknikat infermiore pranë pacientit me sëmundje interne të aparatit kardio-vaskular, respirator, lokomotor dhe sëmundje alergologjike.</p>						
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë		
5	6	7	8	9	10		

### LITERATURA

<b>Literatura bazë</b>	1. "Cikël leksionesh Bazat e Kirurgjisë për Infermierët" Prof. Dr. Yllka Bilushi
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Teksti i Kirurgjisë së Përgjithshme .Vlore 2006. Dr. Odise Papa; A.Gjylbegu.</li> <li>○ Semiotika në kirurgji . Tirane.2012. Edmond Celiku</li> <li>○ Clinical Handbook for Medical-Surgical Nursing :Clinical Reasoning in Patient Care(6th Edition) Sep. 3 2015.</li> </ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<ul style="list-style-type: none"><li>○ Textbook of Medical-Surgical Nursing 12–th . Edition.Brunner and Duddarth.</li></ul>
--	--

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.